REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

Në bazë të nenit 40.2 shkronja (d) dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.03.2022, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT TË KOMUNITETEVE MARS-DHJETOR 2022

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Komitetit të Komuniteteve të Kuvendit të Komunës së Deçanit, Mars-Dhjetor 2022.

Neni 2.

Komiteti i Komuniteteve përveç çështjeve të paraqitura në planin e punës, në periudhën Mars-Dhjetor 2022, do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesave që do të paraqiten.

Neni 3.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Plani i punës së Komitetit të Komuniteteve Mars-Dhjetor 2022.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Deçanit.

Neni 5.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.V-2
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ

11184
07.04.22

Në bazë të nenit 40.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 67 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.03.2022, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË ZYRËS KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM, MARS-DHJETOR 2022

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim të Komunës së Deçanit, Mars-Dhjetor 2022.

Neni 2.

Zyra për Komunitete dhe Kthim përveç çështjeve të paraqitura në planin e punës, në periudhën Mars-Dhjetor 2022 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesave që do të paraqiten.

Neni 3.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për periudhën Mars-Dhjetor 2022.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Deçanit.

Neni 5.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.V-3
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ

Nr. Dok. Kuvendi Komunal 11170
Nr. faqeve 01 Data 07.04.22

Në bazë të nenit 11 dhe 12, paragrafi 12.2.pika d, nenit 17 shkronja (r) dhe (s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 12, paragrafi 12.2 dhe 12.5 të Ligjit Nr.02/L-57 për Institucionet Kulturore, nenit 28 paragrafi 1 pika 4, dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 31.03.2022, bie këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E MUZEUT TË DEÇANIT

Neni 1.

Me këtë vendim Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, për Themelimin e Muzeut të Deçanit, me emërtimin "Muzeu Etnologjik i Deçanit" në Deçan, me qëllim të arkivimit, selektimit, ruajtjes dhe promovimit të relikteve, dokumenteve si dhe gjësendeve tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë historike, individuale dhe shoqërore nga të gjitha periudhat historike.

Neni 2.

Selia e Muzeut do të jetë në Deçan, në hapësirat e Kullës së Zymer Himës, në rrugën "Himë Mushkolaj", nr.20, e evidentuar si pronë e P.Sh.Komuna e Deçanit-Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore Historike, Njësia Kadastrale: P-70505021-01748-0, Zona kadastrale Deçan.

Neni 3.

Përgjegjëse për menaxhimin e Muzeut të Deçanit, është Komuna e Deçanit –Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte.

Neni 4.

Muzeu do të ketë status të institucionit kulturor publik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me Ligjin Nr.02/L-057 për Institucionet e kulturës, Ligjin Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Statut dhe Vendime të Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Neni 5.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte Obligohet që të bëjë përgatitjen e lëndës deri në funksionalizimin e Muzeut, konform Ligjeve të aplikueshme dhe në mbështetje të këtij vendimi.

Neni 6.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.V-5
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

K.K. Deçan AS 11165
01 07.04.22

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja f) dhe p) të Ligjit nr. 03/L–040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), dispozitave të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe nenit 8 paragrafi a) dhe b), neni 15 paragrafi 6) të Statutit të Komunës së Deçanit, nr. 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, me datën 31.03.2022, miraton këtë:

VENDIM
MBI APROVIMIN E RREGULLORES PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE

Neni 1

Me këtë Vendim aprovohet Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullore për Shërbimet Publike Komunale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Drejtoritë përkatëse të Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorive përkatëse të Komunës së Deçanit dhe Arhivi.

01.Nr.V-6
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

K.K. Deçan AS 11172
01 07.04.22

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të nenit 12 paragrafët 12.1 shkronja c) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), sipas Ligjit për Sistemin e Adresave Nr.04/L-071 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.29/27 Dhjetor 2011), Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, dhe në mbështetje të nenit 26 pika 1 dhe pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.03.2022, bie këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për punën e Komisionit për Emërtimin, Riemërtimin e Shesheve, Rrugëve, Rrugicave dhe Vendeve tjera Publike

Neni 1

Me këtë Vendim aprovohet Rregullorja për punën e Komisionit për Emërtimin, Riemërtimin e Shesheve, Rrugëve, Rrugicave dhe Vendeve tjera Publike.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullore për punën e Komisionit për Emërtimin, Riemërtimin e Shesheve, Rrugëve, Rrugicave dhe Vendeve tjera Publike

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Drejtoritë përkatëse të Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorive përkatëse të Komunës së Deçanit dhe Arhivit.

01.Nr.V-7
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

K.K.Deçan AS 11179
01 07.04.22

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë te Ligjit nr. 08/l-066 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, sipas nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.31.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE – BOTIMI I LIBRIT "TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE E KOMUNËS SË DEÇANIT"

I.

Merret Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit të trashëgimisë kulturore i cili do të finalizohet me botimin e librit "Trashëgimia Arkeologjike e Komunës së Deçanit", shuma e mjeteve të miratuara 9,840.00 €.

II.

Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi do të ndahen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit në kategorinë Mallra dhe Shërbime, kodet ekonomike 10/631/16015/13510/00000/111.

III

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.
Vendimi në mungesë të mjeteve buxhetore nuk mund të zbatohet para muajit shtator.

V.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.V-8
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 11168
01 07.04.22

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5,të datës 31.10.2019, sipas paragrafit 2,3 dhe 4 të nenit 24 të Ligjit nr.06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit pasi Rishqyrtoi Vendimin 01.Nr.II-5, Për Ndryshimin e Vendimit 01.Nr.IX-3 të dt.29.06.2021, Për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes publik (për realizimin e projektit "Rregullimi i infrastrukturës në të dy anët e Lumit Lumbardh i Deçanit" pjesa nën Urë të Demës), të miratuar me dt.30.12.2021, Bazuar në raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës të MMPHI Nr.250-2/22, të dt.23.02.2022, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.03.2022, miratoi këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.NR.II-5, TË DT.30.12.2021 PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.IX-3 DT.29.06.2021 PËR SHPALLJEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME ME INTERES PUBLIK

(Për realizimin e projektit " Rregullimi i infrastrukturës në të dy anët e Lumit Lumbardh i Deçanit"pjesa nën Urë të Demës)

I.

Me këtë Vendim bëhet NDRYSHIM-PLOTËSIM I Vendimit, 01.Nr.II-5, të dt.30.12.2021, me të cilin bëhet Anulimi i pjesërishëm (heqja e katër parcelave) nga Vendimi i Kuvendit për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit 01.Nr.IX-3 të dt.29.06.2021 për Shpalljen e pronave të paluajtshme me interes publik, me qëllim te përfitimit publik në Komunën e Deçanit *(Bazuar në raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës të MMPHI Nr.250-2/22, të dt.23.02.2022).*
Parcela të evidentuara si P.SH. Ujëra: P-70505021-02018-0 Z.K. Deçan; P-70511038-02600-2 Z.K. Isniq; P-70511038-02633-3 Z.K. Isniq dhe P-70505085-00654-0 Z.K. Lluka e Epërme.

II.

Ri-Shpallen me interes publik pronat e paluajtshme, me qellim te përfitimit publik në Komunën e Deçanit, parcelat të cilat preken nga realizimi i projektit "Rregullimi i infrastrukturës në të dy anët e Lumit Lumbardh i Deçanit" në Deçan, parcela të cilat gjinden nën Urë të Demës, të cekura më poshtë sipas numrit të parcelave, sipërfaqes dhe zonës kadastrale.

1. **Pjesë nga parcela nr**.0715-1, sipërfaqja e përgjithshme prej 1768 m^2, Z.k.Deçan.
2. **Pjesë nga parcela nr**.0715-2, sipërfaqja e përgjithshme prej 913 m^2, Z.k.Deçan.
3. **Pjesë nga parcela** nr.0715-3, sipërfaqja e përgjithshme prej 913 m^2, Z.k.Deçan.
4. **Pjesë nga parcela nr**.0715-4, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 913 m^2, Z.k.Deçan.
5. **Pjesë nga parcela nr**.0715-5, sipërfaqja e përgjithshme prej 114 m^2, Z.k.Deçan.
   (Sqarim: Për të gjitha parcelat nga nr.0715-1 deri 0715-5 siperfaqja totale qe merret per lumë është 550 m^2).
6. **Pjesë nga parcela nr**.0716-1, sipërfaqja që merret për lumë. 152 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2477 m^2, Z.k.Deçan.
7. **Pjesë nga parcela nr**.0717-1, sipërfaqja që merret për lumë 141 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2554 m^2, Z.k.Deçan.
8. **Pjesë nga parcela nr**.0717-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3892 m^2, Z.k.Deçan sipërfaqja që merret për lumë është 121 m^2.

K.K. Deçan AS 11176
01 07.04.22

9. **Pjesë nga parcela nr**.0718-0, sipërfaqja që merret për lumë 0.272 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1159 m^2, Z.k.Deçan.
10. **Pjesë nga parcela nr**.0720-1, sipërfaqja e përgjithshme prej 763 m^2, Z.k.Deçan.
11. **Pjesë nga parcela nr**.0720-2., sipërfaqja e përgjithshme prej 763m^2, Z.k.Deçan.
(pjesa qe merret për lumë nga parcelat nr.0720-1 dhe 0720-2 është 295 m^2).
12. **Pjesë nga parcela nr**.0721-0, sipërfaqja që merret për lumë .36 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 568 m^2, Z.k.Deçan.
13. **Pjesë nga parcela nr**.0722-1, sipërfaqja që merret për lumë 90. m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 838 m^2, Z.k. Deçan.
14. **Pjesë nga parcela nr**.0724-3, sipërfaqja që merret për lumë 248 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 651 m^2, Z.k.Deçan.
15. **Pjesë nga parcela nr.0725-1,** sipërfaqja që merret për lumë 179 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 180 m^2, Z.k.Deçan.
16. **Pjesë nga parcela nr**.0724-2, sipërfaqja që merret për lumë .79. m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 157 m^2, Z.k Deçan.
17. **Pjesë nga parcela nr**.0724-1, sipërfaqja që merret për lumë 118 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 478 m^2, Z.k.Deçan.
18. **Pjesë nga parcela nr**.0725-4, sipërfaqja që merret për lumë 116 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 137 m^2, Z.k.Deçan.
19. Pjesë nga parcela nr.0725-3, sipërfaqja që merret për lumë 82 m^2 , Z.k.Deçan.
20. Pjesë nga parcela nr.0725-2, sipërfaqja që merret për lumë 142 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 142 m^2, Z.k.Deçan.
21. **Pjesë nga parcela nr**.0726-0, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 323 m^2, Z.k.Deçan sipërfaqja që merret për lumë është 319. m^2.
22. **Pjesë nga parcela nr.**0727-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 390 m^2, Z.k Deçan, sipërfaqja që merret për lumë është 145 . m^2
23. **Pjesë nga parcela nr**.0730-0, sipërfaqja që merret për lumë .1523 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8631 m^2, Z.k.Deçan.
24. **Pjesë nga parcela nr**.2409-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4818 m^2, Z.k.Isniq, sipërfaqja që merret për lumë nga këto dy parcela është 2 m^2.
25. **Pjesë nga parcela nr**.2410-0, sipërfaqja që merret për lumë 522 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 863 m^2, Z.k.Isniq.
26. **Pjesë nga parcela nr**.2391-0, sipërfaqja që merret për lumë 304 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1445 m^2, Z.k.Isniq.
27. **Pjesë nga parcela nr.**2388-0, sipërfaqja që merret për lumë 30 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1164 m^2, Z.k.Isniq.
28. **Pjesë nga parcela nr**.2323-0, sipërfaqja që merret për lumë 143 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 849 m^2, Z.k.Isniq.
29. **Pjesë nga parcela nr**.2322-2, sipërfaqja që merret për lumë 355 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1426 m^2, Z.k.Isniq.
30. **Pjesë nga parcela nr**.2322-1, sipërfaqja që merret për lumë .753 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1270 m^2, Z.k.Isniq.
31. **Pjesë nga parcela nr**.2321-0, sipërfaqja që merret për lumë 316 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 859 m^2, Z.k.Isniq.
32. **Pjesë nga parcela nr**.2320-1, sipërfaqja që merret për lumë 1 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 939 m^2, Z.k.Isniq.
33. **Pjesë nga parcela nr**.2320-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2920 m^2, Z.k.Isniq sipërfaqja që merret për lumë është 102 m^2
34. **Pjesë nga parcela nr**.2313-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2417 m^2, Z.k Isniq sipërfaqja që merret për lumë është .24 m^2

35. **Pjesë nga parcela nr**.2127-0, sipërfaqja që merret për lumë 142 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2802 m^2, Z.k.Isniq.
36. **Pjesë nga parcela nr**.2616-0, sipërfaqja që merret për lumë 39 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22143 m^2, Z.k.Isniq.
37. **Pjesë nga parcela nr**.0074-0, sipërfaqja që merret për lumë 532 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1588 m^2, Z.k.Lluka e Epërme
38. **Pjesë nga parcela nr**.006-0, sipërfaqja që merret për lumë 18 m^2 , Z.k.Lluka e Epërme
39. **Pjesë nga parcela nr**.0073-0, sipërfaqja që merret për lumë 61 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5345 m^2, Z.k.Lluka e Epërme.
40. **Pjesë nga parcela nr**.005-0, sipërfaqja që merret për lumë 1087 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2912 m^2, Z.k.Lluka e Epërme.
41. **Pjesë nga parcela nr**.0648-0, sipërfaqja që merret për lumë 3 m^2 , Z.k.Lluka e Epërme.
42. **Pjesë nga parcela nr**.0072-0, sipërfaqja që merret për lumë 43 m^2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5225 m^2, Z.k.Lluka e Epërme.

III.

.Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

VI.

Vendimi u dërgohet:MAPL,Kryetarit të Komunës, Drejtorive kompetente komunale, Zyrës për Informim dhe Arhivit të Komunës së Deçanit.

01.Nr.V-9
Deçan,dt.31.03.2022

Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (b) dhe nenin 40.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), dhe nenit 37 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, në bazë të kërkesës së MAPL, për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Deçanit, të dt.21.02.2022, nr.0-146/1, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.03.2022, nxjerrë këtë:

VENDIM

MBI APROVIMIN E RREGULLORES PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës së Deçanit, sipas kërkesës së MAPL, për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Deçanit, të dt.21.02.2022, nr.0-146/1.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës dhe Arhivit.

01.Nr.V-10
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

K.K. Deçan AS 11164
01 07.04.22

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniverzitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, neni 6 pika 3.1 Dy anëtarë të komisionit të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi i komunës, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të dt.11.03.2022 me nr.të protokollit 469, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.03.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË DT.28.02.2022 PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË SHKOLLAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Me këtë vendim bëhet PLOTËSIM-NDRYSHIMI i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Deçanit, i dt.28.02.2022 me nr.01.Nr.III-12, për Emërimin e anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit, për vitin shkollor 2021/2022, në të cilin Komision, caktohet edhe Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, siç është paraparë me Udhëzimin Adiministrativ nr.151/2020 dhe rekomanduar nga MASHTI, me shkresën e dt.11.03.2022 me nr.të protokollit 469.
Me plotësim-ndryshimin e vendimit 28.02.2022 me nr.01.Nr.III-12. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit.
2. Avdyl Shala- Ekspert i pavarur i arsimit.
3. Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorëve dhe zv.Drejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit konform procedurave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ(MASHTI) Nr.151/2020.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit i dt.28.02.2022 me nr.01.Nr.III-12.

VI.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, MASHTI, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.V-12/1
Deçan,dt.31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan As 1163
01 07.04.22